




Lojërat e fatit

A është çmimi i lojërave të fatit shumë i lartë? A është bixhozi shkak i konflikteve me familjen tuaj ose në punë? A po kaloni gjithë kohën tuaj në tavolinën e bixhozit ose online?

Mos luani me jetën tuaj! Kërkoni ndihmë.

Ne ofrojmë ndihmë dhe mbështetje për personat e prekur, anëtarët e familjes së tyre dhe rrethin e tyre. Ju informojmë pse lojërat e fatit mund të shkaktojnë varësi dhe ju këshillojmë se si t'i kontrolloni ato. Na kontaktoni për informacion pa asnjë detyrim.

Kosto dhe vendndodhje

Shërbimet tona janë konfidenciale dhe falas. Na gjeni në qendrat tona në Bernë, Biel, Burgdorf dhe Thun ose në njërën nga vendndodhjet tona të tjera rajonale.

Ne ofrojmë përkthim ndërkulturor për të gjitha shërbimet tona, për të lehtësuar komunikimin ndërmjet njerëzve me prejardhje të ndryshme.

Kontakt

Mund të na kontaktoni në beratung@beges.ch ose në numrin falas [0800 070 070](tel:0800070070).